



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KRYETARI

Nr. 3150 prot.

Pogradec, më 15.08 2025

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Znj. Manjola Kamolli, KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojme projekt vendimin, dhe relacionet shoqëruese , për:

**"MIRATIMIN E RINOVIMIT TË KONTRATAVE TË QIRASË PËR AMBIENTE
ARSIMORE NË BASHKINË POGRADEÇ PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026"**

Me respekt

Kryetari



Ilir XHOKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 faqe

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues: 5 faqe

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KRYETARI

Nr. _____ prot.

Pogradec, më _____.2025

PROJEKT-VENDIM

NR _____, DATË _____.2025

PËR

**“MIRATIMIN E RINOVIMIT TË KONTRATAVE TË QIRASË PËR AMBIENTE
ARSIMORE NË BASHKINË POGRADEÇ PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026”**

Në mbështetje të të pikës 2 të nenit 8, shkronjës "a", dhe "c", të nënpikës 1.2 të nenit 9, në pikën 1.2 të nenit 23, nenit 54 shkronja "k", nenit 55, pika 2 dhe 6, të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 21, 22, nenit 28, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjit Nr.10926, datë 08.07.2011, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, në nenin 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", vendimit nr. 621, datë 22.10.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj", vendimi nr. 659, datë 03.11.2021, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021- 2026", në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Pogradec nr.90, datë 29.08.2024, si dhe mbështetur tek Relacionet shpjeguese të Qendrës Arsimore dhe Kërkesat e Administratorëve të Njësive Administrative,

KËSHILLI I BASHKISË
VENDOSI:

1. Miratimin e rinovimit të kontratave të qirasë për ambiente arsimore publike në Bashkinë Pogradec, të cilat do të shërbejnë për zhvillimin e procesit mësimor për vitin shkollor 2025-2026.
2. Rinovimi i kontratave sipas pikës një të këtij vendimi, hyn në fuqi më datë 01.09.2025, që korrespondon me fillimin e Vitit të Ri shkollor 2025-2026 dhe do të zgjasë deri në dt. 01.07.2026.

3. Vlerat e kontratave dhe Kushtet e tjera të tyre mbeten të pandryshuara. Vlerat e qerasë mujore për secilën Njësi Administrative janë si më poshtë:

3.1 **Fshati Selcë e Poshtme Njësia Administrative Proptisht, Bashkia Pogradec,** Rinovimin e kontratës së qirasë për ambientin që shërben si shkollë, me vlerë 8,000 (tetë mijë) lekë në muaj, për periudhën Shtator 2025 - Korrik 2026.

3.2 **Fshati Buzaishtë, Njësia Administrative Velçan, Bashkia Pogradec:** Rinovimin e kontratës së qirasë për ambientin që shërben si kopsht me vlerë 6,000 (gjashtë mijë) lekë në muaj, për periudhën Shtator 2025 - Korrik 2026.



3.3 **Fshati Stropçkë, Njësia Administrative Dardhas, Bashkia Pogradec:** Rinovimin e kontratës së qirasë për ambientin që shërben si kopsht, me vlerë 8,000 (tetë mijë) lekë në muaj, për periudhën Shtator 2025 - Korrik 2026.

4. Mosrinovimi i kontratës së qirasë për ambientin që shërbente si shkollë (arsim fillor) në fshatin Buzaishtë, Njësia Administrative Velçan për periudhën Shtator 2024 - Korrik 2025, pasi nuk plotësohen kriteret minimale të vendosura nga MAS përsa i përket numrit minimal të regjistrimeve të nxënësve për vitin mësimor 2025-2026

5. Për zbatimin e vendimit, ngarkohet Qendra Arsimore pranë Bashkisë Pogradec.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETAR
Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. _____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2025

RELACION

PËR

MIRATIMIN E RINOVIMIT TË KONTRATAVE TË QIRASË PËR AMBIENTE ARSIMORE NË BASHKINË POGRADEC PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026¹

Të nderuar këshilltarë!

Projekt-vendimi që po ju paraqesim vjen si një detyrim ligjor që ka Këshilli i Bashkisë Pogradec për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, shkronjës "a", dhe "c", të nënpikës 1.2 të nenit 9, në pikën 12 të nenit 23, nenit 54 shkronja "k", nenit 55, pika 2 dhe 6, të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 21, 22, nenit 28, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjit Nr.10926, datë 08.07.2011, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, në nenin 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", vendimit nr. 621, date 22.10.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj", vendimi nr. 659, datë 03.11.2021, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021- 2026", në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Pogradec nr.90, datë 29.08.2024, si dhe mbështetur tek Relacionet shpjeguese të Qendrës Arsimore dhe Kërkesat e Administratorëve të Njërive Administrative, me anë të këtij relacioni argumentues, Qendra Arsimore, Bashkia Pogradec, po paraqet një justifikim të detajuar dhe të bazuar në nevojat aktuale për miratimin e rinovimit të kontratave të qirasë për ambientet dhe objektet që kanë shërbyer si kopshte dhe shkolla në Bashkinë Pogradec, për vitin shkollor 2025-2026.

Propozimi mbështetet në një sërë argumentesh thelbësore, të cilat i japin prioritet mirëqenies dhe të drejtës së fëmijëve për arsim, duke siguruar vazhdimësinë e procesit mësimor në zonat ku mungojnë infrastrukturat publike të përshtatshme.

¹Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

Argumenti kryesor: Mbrojtja e të drejtës për arsim dhe funksionimi i sistemit arsimor

Argumenti më i fortë në favor të këtij propozimi është **mbrojtja e të drejtës kushtetuese të fëmijëve për arsim**. Legjislacioni shqiptar, si dhe standardet ndërkombëtare, garantojnë qasjen e barabartë në arsimin parashkollor dhe fillor. Në tre rastet e paraqitura – në fshatin Selcë e Poshtme, Buzaishtë dhe Stropckë – strukturat publike arsimore janë ose jashtë standardeve, ose të rrënuara, ose nuk ekzistojnë më.

Rinovimi i kontratave të qirasë shërben si **zgjidhja e vetme dhe imediate** për të shmangur ndërprerjen e procesit mësimor për një numër të konsiderueshëm fëmijësh. Kjo masë e përkohshme siguron që arsimi të vazhdojë pa vonesa, duke adresuar një problem kritik të identifikuar nga administratorët e njësive administrative dhe drejtuesëve.

Situata e rinovimit në të njëjtat ambiente: Mungesa e alternativave

Rinovimi i kontratave në të njëjtat ambiente ka një shkak të thjeshtë dhe thelbësor: **mungesa e alternativave të tjera të përshtatshme** në këto zona. Siç theksohet në relacion, ambientet arsimore publike ose janë totalisht të rrënuara, ose jashtë standardeve, ose nuk ekzistojnë fare. Ndërkohë, godinat që kanë shërbyer deri tani me qira kanë rezultuar të përshtatshme për vazhdimin e procesit mësimor, duke përmbushur kushtet minimale për zhvillimin e mësimi.

Prandaj, rinovimi i kontratave nuk është zgjedhje, por domosdoshmëri. Ai siguron vazhdimësinë e një shërbimi esencial pa ndërprerje, duke i ofruar Bashkisë kohën e nevojshme për të planifikuar dhe investuar në zgjidhje më afatgjata, si ndërtimi apo rikonstruksioni i godinave të reja, pa dëmtuar të drejtën e fëmijëve për arsim. Ky është një proces pragmatik, që jep prioritet interesit më të lartë të fëmijëve.

Përgjegjëshmëria administrative dhe efikasiteti i menaxhimit të burimeve

Bashkia Pogradec, në cilësinë e saj si qeverisje vendore, ka përgjegjësinë ligjore dhe morale për të siguruar shërbime publike bazë, përfshirë arsimin. Ky propozim dëshmon një qasje proaktive dhe të përgjegjshme nga ana e administratës, e cila, në mungesë të alternativave afatgjata, gjen një zgjidhje efektive dhe me kosto të ulët për të garantuar shërbimin.

Kostot e qirasë (8,000 lekë dhe 6,000 lekë në muaj) janë shpenzime minimale në raport me rëndësinë e arsimimit të fëmijëve. Këto shpenzime janë një investim thelbësor për të ardhmen, i cili siguron stabilitet në komunitete dhe i përgjigjet drejtpërdrejt kërkesave të vazhdueshme të prindërve.

Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 90, datë 29.08.2024, tashmë ka miratuar përdorimin e këtyre ambienteve, duke krijuar një bazë ligjore dhe administrative për vazhdimësinë e këtij procesi.

Përmbushja e angazhimeve strategjike dhe ligjore

Ky propozim nuk është vetëm një masë emergjence, por edhe një veprim në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjik kombëtar. Ai mbështetet tek:

¹Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

- **Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar"**, i cili kërkon krijimin e kushteve të nevojshme për funksionimin e shkollave.
- **Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026:** e cila synon përmirësimin e infrastrukturës arsimore. Përdorimi i ambienteve me qira, në këtë rast, është një mjet për të arritur këtë qëllim në mungesë të strukturave publike.
- **Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026:** E cila thekson rëndësinë e sigurisë dhe mirëqenies së fëmijëve, duke përfshirë aksesin e tyre në institucione arsimore funksionale.

Sa më sipër, në relacionin shpjegues po ju paraqesim argumentat ligjore në mënyrë konkrete në lidhje me ambientet e nevojshme për rinovimin e kontratave të qirasë.

1. Fshati Selcë e Poshtme në Njësinë Administrative Proptisht, Bashkia Pogradec.

Fëmijët në fshatin Selcë e Poshtme të cilët frekuentojnë shkollën e kanë të pamundur të shkojnë në ambientet e saj pasi shkolla në këtë fshat është totalisht jashtë standarteve dhe nuk mund të kryhet procesi mësimor. Në këto kushte, duke mos patur një ambient publik të përshtatshëm që fëmijët të zhvillojnë procesin mësimor në këtë fshat, nevojitet një ambient privat për mbarëvajtjen e procesit mësimor për vitin shkollor 2025-2026. Kjo shkollë do të frekuentohet nga 10 fëmijë përkatësisht nga klasa e parë deri në klasën e katërt.

Duke patur parasysh se nga ana e drejtueses së shkollës dhe Administratorit të Njësisë Administrative Proptisht, na është bërë i ditur ky problem si dhe në interesin më të lartë të fëmijëve që mbeten pa arsim dhe në përgjigje ndaj kërkesave të vazhdueshme të prindërve, kemi menduar si të vetmen alternativë për një zgjidhje të përkohshme marrjen me qira për periudhën Shtator-Korrik, një ambient për vazhdimësinë e procesit mësimor.

Fshati Selcë e Poshtme në *Njësinë Administrative Proptisht*. Ambienti shërben si shkollë bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.90 datë 29.08.2024.

Vlera e qerasë 8.000 lekë në muaj.

2. Fshati Buzaishtë në Njësinë Administrative Velçan, Bashkia Pogradec.

Fëmijët në fshatin Buzaishtë të cilët frekuentojnë kopshtin e kanë të pamundur të shkojnë në ambientet e tij pasi në këtë fshat procesi mësimor zhvillohej në një godinë private që nuk është më në dispozicion. Në këto kushte, duke mos patur një ambient publik të përshtatshëm që fëmijët të zhvillojnë procesin mësimor në këtë fshat, nevojitet një ambient tjetër privat për vitin shkollor 2025-2026. Ky kopsht do të frekuentohet nga 12 fëmijë

Duke patur parasysh se nga ana e drejtueses së shkollës dhe Administratorit të Njësisë Administrative Velçan, na është bërë i ditur ky problem si edhe në interesin më të lartë të fëmijëve që mbeten pa arsim dhe në përgjigje ndaj kërkesave të vazhdueshme të prindërve, kemi menduar

¹Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

shërbent me alternativë për një zgjidhje të përkohshme marrjen me qira të një ambienti privat duke siguruar vazhdimësinë e procesit mësimor.

Fshati Buzaishtë në Njësine Administrative Velçan. Ambienti shërben si kopsht bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.90 datë 29.08.2024.

Flora e qerasë 6.000 lekë në muaj.

3 Fshati Stropckë në Njësine Administrative Dardhas, Bashkia Pogradec.

Fëmijët në fshatin Stropckë të cilët frekuentojnë kopshtin e kanë të pamundur të shkojnë në ambientet e tij pasi kopshti në këtë fshat prej shumë vitesh është totalisht i rrënuar dhe nuk mund të kryhet procesi mësimor. Në këto kushte, duke mos patur një ambient publik të përshtatshëm që fëmijët të zhvillojnë procesin mësimor në këtë fshat, nevojitet një ambient privat për mbarëvajtjen e procesit mësimor për vitin shkollor 2025-2026. Ky kopsht do të frekuentohet nga 6 fëmijë

Duke patur parasysh se nga ana e drejtueses së kopshtit dhe Administratorit të Njesisë Administrative Dardhas, na është bërë i ditur ky problem si dhe në interesin më të lartë të fëmijëve që mbesin pa arsim dhe në përgjigje ndaj kërkesave të vazhdueshme të prindërve, kemi menduar të shërbent me alternativë për një zgjidhje të përkohshme marrjen me qira për periudhën Shtator-Korrik, një ambient për vazhdimësinë e procesit mësimor.

Fshati Stropckë në Njësine Administrative Dardhas. Ambienti shërben si kopsht bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.90 datë 29.08.2024.

Flora e qerasë 8.000 lekë në muaj.

*** Fshati Buzaishtë në Njësine Administrative Velçan, Bashkia Pogradec.**

Bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.90 datë 29.08.2024, në fshatin Buzaishtë në Njësine Administrative Velçan ka patur edhe një ambient tjetër që ka shërbyer si shkollë për vitin mësimor 2024-2025 me vlerë qeraje mujore prej 6.000 lekë në muaj. Por për këtë vit të ri mësimor është evidentuar një rënie e konsiderueshme e regjistrimeve të nxënësve duke mos plotësuar kështu as kapacitetin minimal të vendosur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për të krijuar një klasë të re.

Duke qenë se kjo godinë nuk do të funksionojë më tej si shkollë, Qendra Arsimore, drejtoria e shkollës si edhe Njësia Administrative Velçan kanë marrë masa që nxënësit e regjistruar ti bashkohen shkollës qendër në fshatin Velçan.

Në përfundim, rinovimi i këtyre kontratave është një veprim i domosdoshëm, i justifikuar plotësisht nga rrethanat specifike të secilit fshat dhe i bazuar në parimet e përgjegjësisë administrative dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Ndërmarrja e kësaj mase siguron që fëmijët në këto komunitete të mos mbeten pa arsim, ndërkohë që kërkohen zgjidhje më afatgjata për infrastrukturën arsimore.

Miratimi i këtij propozimi do të dëshmonte një angazhim të fortë ndaj cilësisë së arsimit dhe mirëqenies së qytetarëve të Bashkisë Pogradec.

Duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, ju ftojmë ta votoni propozimin për miratimin e projekt-vendimit "Miratimin e rinovimit të kontratave të qirasë për ambiente arsimore në bashkinë pogradec për vitin shkollor 2025-2026"

Ftojmë Këshilltarët të votojnë këtë Projekt-Vendim

Faleminderit!

Të dhënat e Projekt-Vendimit:

Konceptoi: L. SHKULLAKU


Miratoi: A. ANDONI

Konfirmoi: Irsa KARAPANCA

Dritan BABASULI

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Pogradec, më _____, 2025

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN
PËR
“MIRATIMIN E RINOVIMIT TË KONTRATAVE TË QIRASË PËR AMBIENTE
ARSIMORE NË BASHKINË POGRADEC PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026”,

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, **“Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.”**

Po kështu, në ligjin 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: **“Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.**

Më tej, ky ligj në nenin 8 shkronja “a” përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Nga sa më sipër organet përgjegjëse pranë bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative", neni 3, pika 2 përcakton si vijon: "Akt normativ nënligjor" është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij".

Neni 3 pika 1 shkronja "a" e Kodit të Procedures Administrative jep kete perkufizim për 1. "Akti administrativ":

a) "**Akti administrativ individual**" është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) "Akti administrativ kolektiv" është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që ju drejtohet një numri të pacaktuar subjektsh.

Në rastin e këtij Projekt - Vendimi, gjykojmë se ai është një projekt-vendim i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 1 "a", të Ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative", pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik **për interes të një apo më shumë subjektsh të së drejtës të përcaktuar individualisht**, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete dhe që me miratimin e tij do të sjellë pasoja juridike për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe rinovimi i këtyre kontratave është një veprim i domosdoshëm, i justifikuar plotësisht nga rrethanat specifike të secilit fshat dhe i bazuar në parimet e përgjegjësisë administrative dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Ndërmartja e kësaj mase siguron që fëmijët në këto komunitete të mos mbeten pa arsim, ndërkohë që kërkohen zgjidhje më afatgjata për infrastrukturën arsimore, për vitin shkollor 2025 – 2026.

Përfundimisht konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës individuale dhe si i tillë nuk kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti Qarkut Korçë, sipas ligjit.

Propozoi dhe interpretoi karakterin e aktit juridik: K.TANE



KRYETAR

Ilir XHAKOLLI

